



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 31.1.2012, e cila filloi në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Hetem Kupina, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Avdush Dobratiqi, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Fetah Salihu, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Shefki Uka, Musli Mehaj, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Remzi Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Valon Hiseni, Shemsi Veseli, Liridon Restelica, Skënder Reçica, Afërdita Veliu, Besa Halimi - Zagragja, Lumnie Rama, Shefqet Sylejmani, Astrit Hasani, Mejreme Berisha, Shefki Gashi, Besa Rafuna, Feti Mehdiu, Kimet Zeqa, Sadri Ramabaja dhe Engin Beyoglu.

Mungoi Meliza Haradinaj.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE - së dhe të mjeteve të informimit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Sami Hamiti**, kryesues i Kuvendit.

Para se të fillonin me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, **kryesuesi** hapi diskutimin rreth rendit të ditës.

Shefki Gashi kërkoi që në këtë mbledhje të diskutohet dhe të trajtohet gjendja aktuale e rrugëve në komunën e Prishtinës, gjegjësisht kaosi i shkaktuar si pasojë e të reshurave të borës.

Sadri Ramabaja tha se njëri nga pikat që desha ta propozoj, e propozoi z. Gashi, e mirëpres dhe e falënderoj, natyrisht që plani është tek keq menaxhimi dhe do të duhej gjithsesi ta diskutonim.

Dy çështje tjera për të cilat kisha shtruar ose pyetje, që për hir të orarit, respektivisht të ekspeditivitetit, të më jepet përgjigje ndoshta edhe më vonë.

Fjala është për një kërkesë që e ka bërë qendra e Vetëvendosjes për një zyrë, me shkrim e ka dorëzuar, dhe nuk ka përgjigje tsh e dy muaj. Në bazë të informacioneve që kemi, thuhet se zyrat e bashkësive lokale i shfrytëzon LDK-ja, andaj ose duhet të na lëshohen edhe neve të tjerëve që t'i shfrytëzojmë me orar të caktuar, ose do duhej të vepronim si komunitat tjera që vejnë në dispozicion një lokal për funksionimin e partive politike. Për këtë çështje kërkojmë një përgjigje recidive, me shkrim, nga ju z. kryesues.

Çështja e dytë, që kisha shtruar, është që, nëse jo sot, atëherë në mbledhjen e ardhshme, të na jepet një raport për menaxhimin, respektivisht keqmenaxhimin e kompanisë "Pastrimi", respektivisht blerjen vend e pa vend të veturave në këtë kohë krize ekonomike.

Shemsi Veseli tha se në Komitet për Politikë dhe Financa, por edhe më parë, në emër të GP të PDK – së, kam kërkuar një informatë rreth suksesit të nxënësve në gjysmëvjetorin dhe vijueshmërinë. Nëse nuk do të jepet në këtë mbledhje, do të ishte mirë që për mbledhjen e ardhshme gjithsesi të jetë një informatë e shkurtër nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit.

Sa i përket kërkesave të grupeve parlamentare lidhur me ofrimin e një zyre në objektin e Komunës, konsideroj se një kërkesë e tillë qëndron dhe është e justifikueshme, prandaj në qoftëse këto grupe e kanë një hapësirë veprimi, do ta pasuronin jetën demokratike në komunën e Prishtinës.

Vjollca Dibra tha se përveç disa çështjeve që kryesisht kanë të bëjnë rreth vijueshmërisë së mësitit, e që u cekën nga z. Veseli, ka edhe disa probleme tjera që besoj se paraprakisht duhet të shqyrtohen, trajtohen ndoshta njëherë në Komitetin për Arsim dhe se në mbledhjen e radhës së Kuvendit ta kemi edhe si pikë të veçantë në rendin e ditës.

U konstatua se njëzëri u miratua ky

R E N D D I T E :

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dymbëdhjetë;**
- 2. Propozimrregullorja për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve;**
- 3. Propozimvendimi për vazhdimin e afatit të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale;**
- 4. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare;**
- 5. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qendrës së Mjekësisë Urgjente;**
- 6. Pyetje dhe përgjigje;**
- 7. Të ndryshme.**

Pika e parë

Sadri Ramabaja bëri vërejtje në pikën e tretë të ekstraktit, duke thënë se në vend të fjalës *dispozitiv* është shkruar *diapozitiv*, andaj dhe duhet të jetë: "*hartuesit e këtij dispozitivi*".

Gjithashtu kërkoi që në fund të çdo pike, të shënohet kush ka votuar kundër, pasi që kjo parshihet me nenin 7 të Rregullore së Kuvendit.

Me vërejtjen e dhënë, me shumicë absolute votash, një kundër (Sadri Ramabaja), u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dymbëdhjetë.

Pika e dytë

Lidhur me Propozimrregulloren për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve, informoi shefi i Zyres ligjore, z.Agim Salihu.

Tefik Mehmeti, në emër të GP të LDK-së, tha me që kjo rregullore është tekst i spastruar, do të thotë se nuk e prekë më shumë se 20-30 % të rregullores së më pashme, ne pajtohemi me këto ndryshime të vogla që janë bërë apo janë aprovuar, edhe me ato arsyetime që u dhanë. Një vërejtje do të ishte në nenin 20, pika 2, është mirë të shtohet aty “drejtuesi i automjetit taksi detyrohet të jetë në automjet apo pranë”, për arsye se në njëfarë forme po e obligojmë që ai të jetë gjithmonë në automjet. Besoj se edhe pika 3 është pak në kundërshtim me nenin 19, meqenëse atje caktohet që të jetë në vend parking. Gjithashtu duhet të analizohet më mirë edhe pika 3 e nenin 20, që të mos jetë në kundërshtim me pikën 4 të këtij neni.

Grupi parlamentar i LDK-së me këto ndryshime dhe përmirësime dhe me mundësinë që të përmisohet neni 20, e voton për miratim këtë rojektregullore.

Aziz Pacolli tha se rreth kësaj rregulloreje është diskutuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa, andaj do të shtroja një kërkesë, që Komuna e Prishtinës dhe ajo e Lipjanit, të takohen dhe bashkarisht ta zgjedhin problemin e taksive në Aeroportin e Prishtinës. Njëherësh me miratimin e kësaj rregulloreje, Komuna do të tentojë që të largojë edhe taksitë ilegale apo taksitë që punojnë në të zezë, kështu që si GP i AKR-ës e përkrahim për miratim këtë rregullore.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, tha se këtë material e kemi analizuar dhe në parim e mbështesim dhe e përkrahim. Kjo rregullore nuk ka qenë pengesë që deri tash të rregullohet çështja e autotaksive, mirëpo duhet pak një angazhim dhe një punë më e madhe e të gjithave institucioneve, në këtë rast, si inspektorati, ashtu edhe policia, në raport me ndalimin dhe parandalimin e personave, operatorëve që veprojnë pa leje pune.

Në këtë rregullore nuk është paraparë që të jetë ngjyra e njëjtë e autotaksive, kur dihet se më parë kemi marrë një qëndrim për këtë çështje, andaj dhe është tejkualuar.

Disa ndryshime që u propozuan në Komitetin për Politikë dhe Financa, shihet se nuk janë zbatuar. Përkundër vërejtjeve dhe sugjerimeve, GP i PDK-së e voton për miratim këtë projektregullore.

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, tha se vërejtjet tona i kemi dhënë në Komitetin për Politikë dhe Financa, dhe konsideroj se kemi qenë mjaft aktiv. Disa nga vërejtjet dhe sugjerimet tona janë inkorporuar, ndërkaq pjesa tjetër konsideroj se nuk janë inkorporuar, por besoj se do të jenë pjesë e ndryshimeve në të ardhmen.

Pajtohemi edhe me vërejtjen e dhënë nga GP të LDK-së, se vërtet është pak e tepërt të qëndrohet tërë kohë në automjet, sidomos gjatë sezonit të verës, prandaj duhet të jemi më fleksibil në këtë kuptim dhe, në anën tjetër, me vërejtjen e GP të AKR-ës, se duhet të intervenohet në kuptimin e një bashkëbisedimi me organet komunale të komunës së Lipjanit rreth punës së taksistëve në aeroportin “Adem Jashari” të Prishtinës.

Konsideroj se kanë qenë më se të domosdoshme ato ndryshime dhe plotësime dhe konsiderojmë që kjo rregullore do ta ndihmojë në masë jashtëzakonisht të madhe edhe mbarëvajtjen e punës së trafikut urban në Prishtinë.

Urojmë dhe sugjerojmë që Inspekcioni me këtë Rregullore dhe, veçanërisht me paragrafin që e paraqiti edhe shefi i Zyrës ligjore, ku janë paraparë edhe ndëshkimet etj., të jenë më në nivel të punës dhe detyrës dhe të kemi një mbarëvajtje në këtë sferë të jetës.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, tha se pajtohem me diskutimet e parafolësve rreth kësaj rregulloreje, me përjashtim të nenit 6, ku thuhet "*transportin taksi të udhëtarëve mund ta ushtrojnë personat fizikë, të cilët e kanë profesion të vetëm dhe operatorët juridikë, të cilët i plotësojnë kushtet e caktuara me Ligj*". Në tregun e lirë, në vendet e zhvilluara, njerëzit mund të kryejnë edhe punë dytësore, sepse vetëm të ardhurat prej të hyrave buxhetore dhe çfardo qoftë, e kanë të drejtën të ushtrojnë edhe një veprimtari tjetër nëse janë të kualifikuar, që don të thotë se përveç atij që është shofer, që merret vetëm me auto-taksi, mundet edhe ndonjë zyrtarë apo ndonjë person tjetër, i cili me punën në aktivitetin e lirë, mund t'i plotësoj nevojat e veta ekonomike.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se pajtohem me diskutimet e parafolësve, por përveç te zgjidhja se vozitësi i auto-aksit a do të jetë në automjet apo pranë automjetit, mendoj se është e drejtë edhe e saktë të jetë "*te automjeti*", që mos t'i kufizohet që të mos jetë as brenda, por edhe ajo pranë automjetit.

Sadri Ramabaja në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, fillimisht uroi përcjelljen e mbledhjes nga MPAL-ja përmes një televizioni, por këto mbledhje do të ishte mirë që t'i përcillte edhe qytetari, sepse atëherë do të reflektonim më ndryshe dhe do të ishim ndoshta edhe më serioz në punën tonë këtu.

Ne përshëndesim çdo rregull, çdo rend, çdo përpjekje për të vënë rend në qendër, ndërkaq me këtë projekt rregullore po pretendohet diçka e tillë.

Megjithatë, u veneruan edhe nga kolegët disa lëshime që kanë edhe karakter logjik, por edhe profesional etj., se neni 6 është në shpërputhje me realitetin tonë social në Kosovë. Kisha apeluar që këtu të hiqet kjo thurje, që në njëfarë mënyre ka edhe shkaqe logjike, por do të thotë që kanë të vetmin profesion taksinë, sepse sot në botën moderne nuk ka një qytetar që e ka vetëm një profesion dhe është vështirë që të përcaktohet, por le të theksohet ai që ka leje sipas ligjit. Nëse një arsimtar, një mjek apo një mësues merr lejen sipas ligjit, ai në orar të caktuar së paku 50% të veprimtarisë si taksist ia lejon edhe ligji.

Në nenin 20, pika 5, që ka të bëjë rreth përcaktimit të vendqendrimit në distancë prej 100 m larg stacionit të autobusëve, konsideroj se ky përkufizim nuk qëndron, pasi që duhet marrë parasysh hapësirat ekzistuese, kur dihet se kryeqendra jonë ka hapësira tepër të kufizuara, dhe si shembull konkret mund

të jetë vendqendrimi i autotaksive te shkolla e mesme e mjekësisë "Ali Sokoli" që nuk janë më larg se 15-20 m nga stacioni i autobusëve. Për distancën prej 100 m, mendoj se është relativisht larg, dhe një arsye tjetër është se afër të të gjitha stacioneve të autobusëve dhe të trenave, sikurse që ekzistojnë në të gjitha stacionet e botës, duhet të ketë auto-taksi.

Për zgjidhjen e problemit të autotaksive në Aeroportin e Prishtinës, si zgjidhje më e mirë do të ishte lëshimi i një linje të trafikut urban që do t'i përcillte oraret e rregullta së paku të udhëtarëve nga jashtë. Këtë çështje e kemi potencuar këtu disa herë, se ne jemi i vetmi vend që nuk kemi linjë të rregullt në Aeroport. Qytetarët

tanë, sidomos mërgimtarët, në këtë mënyrë i lëmë në mëshirën e një pjese të punëtorëve të rregullt, të cilët e nxjerrin bukën me atë punë, por edhe një pjese të matrapazëve. Për zgjidhje të këtij kaosi do të ishte mirë të lejohej funksionimi i një linje të rregullt të trafikut urban Prishtinë- Aeroport.

Afërdita Veliu bëri vërejtje tek nenin 7, përkitazi me plotësimin e kushteve, tek pika "d", ku thuhet se *personi fizik duhet të ketë së paku dy vjet përvojë pune si drejtues i automjetit*. Mendoj se duhet të përpilohet në mënyrë tjetër, duhet të ketë dy vjet përvojë pune në ushtrimin e kësaj veprimtarie, sepse drejtues automjeti ne jemi të gjithë edhe nuk besoj, nuk mendoj që përvojë pune mund të quhet ngasja e automjetit, e kam fjalën nëse nuk e shfrytëzon për një veprimtari të caktuar.

Lidhur me disa vërejte dhe sugjerime, si dhe rreth çështjes dhe problemit të autotaksive në Aeroportin e Prishtinës, **kryesuesi** dha sqarime të nevojshme.

Me vërejtje dhe sugjerime, njëzëri u miratua Rregullorja për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksit të udhëtarëve.

Pika e tretë

Lidhur me Propozimvendimin për vazhdimin e afatit të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale, **Agim Salihu** i njoftoi të pranishmit, duke dhënë sqarime të nevojshme rreth inicimit të procedurës për vazhdimin e afatit të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale.

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, tha se në parim e përkrahim këtë propozimvendim, por kërkojmë nga drejtoritë përkatëse që të shikohet se a i shfrytëzojnë këto prona parashtruesit e kërkesave, apo mos janë bartur te personat e tretë. Nëse ka raste të tilla, atyre të iu merret e drejta e shfrytëzimit, gjithashtu në rastë se nuk kanë kryer obligime ndaj Komunës, të mos iu vazhdohet e drejta e shfrytëzimit të pronave pa i kryer të gjitha obligimet që mund t'i kenë.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR – së, përkrahu propozimin që për të gjitha parcelat që i kanë plotësuar kushtet, të zgjatet afati për 3 vjet, ndersa ato që nuk i kanë plotësuar kushtet dhe obligimet ndaj Komunës, t'iju ndërpritet kontrata.

Vërejtja tjetër do të ishte lidhur me shkollën "Don Bosko". Dihet se kjo ka qenë një shkollë profesionale dhe tani mësimi këtu bëhet me pagesë prej nxënësve, andaj jamë që të mos i vazhdohet afati prej 10 vjetësh. Kërkoj nga Zyra ligjore që afati prej 10 vjetësh të shyrtohet edhe një herë, pasi që legjislacioni i ardhshëm e kalon mandatin pa e ditur punën e shkollës "Don Bosko", se a është pronë e komunës apo është pronë private.

Klubit futbollistik "Prishtina", kërkoj t'i jepet objekti në shfrytëzim për 10 vjet, me një sugjerim që të dihet se ato objekte, lokale, të cilat janë në Stadiumin e Prishtinës, të dihet se kush merret me to dhe kujt i pergjigjen me tatimin dhe dhënien e qirasë.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, tha se pas analizave që i kemi bërë këtij materiali, kemi vërejtur se disa kërkesa që kanë të bëjnë me nivelin qendror që nuk i nënshtrohen Ligjit dhe prokurimit, që e sanksionon faktikisht ligji, nuk janë përfillur, janë shmangur nga Zyra ligjore. Duke pas faktin dhe argumentet, në preambul të formulimit të këtij propozimi ka shkelje dhe rrjedhja e procedurës se si ka shkuar, atëherë ne normalisht që nuk do ta votojmë këtë propozim.

Pajtohem plotësisht me disa vërejtje të z. Krasniqi, vërejtje të cilat edhe ne i kemi paraqitur në Komitetin për Politikë dhe Financa. Drejtoria gjegjëse domosdo është dashtë që të paraqet arsyet dhe argumentet, që më pas ne të marrin një vendim të

tillë, e jo të dalim në pozita të tilla qesharake dhe të merret vendim. Si shembull konkret mund të merret "Don Bosko", ku asnjë trajnim nuk bëhet pa pagesë dhe, pavarësisht nga kjo, tani asaj i vazhdohet afati edhe për 10 vjet, andaj dhe bie në kundërshtim me ligjin. Për këtë rast konkret është dashtë të jepet një arsytim edhe nga Kryetari dhe t'i propozojë Kuvendit se cili është interesi publik, d.m.th arsyeshmërinë koncize që të ju jepet këtyre në shfrytëzim.

Për dhënien e tokës në shfrytëzim është dashtë të rrespektohen disa prej parimeve themelore të ligjit që i parasheh për dhënien e tokës komunale në shfrytëzim, andaj dhe në rastin konkret që jepet toka në shfrytëzim, fare nuk janë respektueshme këto parime.

Duke i pasur për bazë të gjitha këto çështje se nuk është bërë verifikimi, nuk është dhënë një mostër e kontratave për te ditur se çka përmban ajo kontratë, sa është faktikisht obligimi i atij operatori që e merr në raport me Komunën.

Do të ishte mirë që, në të ardhmen, çdo propozim që na vjen, të na prezantohet me material ndonjë mostër e kontratave të këtilla.

Duke i pasur për bazë të gjitha këto që u cekën, që nënkupton se ka shkelje ligjore, GP i PDK-së nuk e voton këtë dhe nuk pajtohet me një formë të tillë veprimi.

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, tha se sugjerimet që i kemi dhënë në Komitet për Politikë dhe Financa janë të përkrahura edhe në GP, pas shqyrtimit që i kemi bërë këtij materiali dhe qëndrojmë aty. Disa nga vërejtjet janë inkorporuar, ndërkaq disa që u përmenden edhe nga z. Veseli qëndrojnë, prandaj jemi pranë atyre vërejtjeve tona.

Ne do ta votojmë këtë dokument, por duke e lënë mundësinë që për raste të sakta, të dyshimta etj. që t'i paraqesim edhe në seancat e rregullta të Kuvendit të Komunës, nuk d.m.th. se duhet pritur vetëm kur paraqitet rasti i vazhdimit të afateve. Rreth qasjes së kësaj problematike dua të shtoj vetëm një çështje, se a ka edhe prona që sot shfrytëzohen nga të tjerët, janë prona komunale, e në anën tjetër, ata pronarë as që tregojnë interesim për të bërë kërkesa për vbazhdimin e afatit për shfrytëzim. Do të ishte mirë që në një mbledhje të ardhshme, të na jepet numri i atyre pronarëve dhe parcelave, dhe të shohim çka mëtutje. Mendoj se për secilin vazhdim që do ta bëjmë, do të ishte mirë ta kemi parasysh atë çka e kemi thënë, a janë në nivel të misionit së pari dhe a janë konform përgjegjësive që kanë ndaj organeve të Komunës së Prishtinës, përndryshe do të ishte plotësisht e paarsyeshme ata që nuk janë në këto dy binarë, të jenë edhe përfitues të vazhdimit të këtyre kontratave. Gjithashtu kisha dashur ta di edhe njëherë a kemi edhe të tjerë që janë në skadim e sipër apo u ka skaduar afati, dhe çka do të bëhet me ta, duke e ditur që ligjet tona, për fat të keq, dinë nganjëherë të vonohen dhe me vonimin të tjetërsohet prona. Sugjeroj që ekzekutivi, por edhe organet tjera të Komunës, ta përcjellin dhënien e objekteve për 10 vjet, sepse ato që u tha me të drejtë, mandatet për fat po zgjasin më shkurt se sa këto 10 vjet edhe mund të harrohen, edhe dikush mezi nuk pret që të harrohen gjërat, po them edhe njëherë duke falënderuar disa ligjeve tona, mundet me u shndëruar ajo në pronë private nesër apo pasnesër.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së shprehu mendimin e tij, duke thënë se ka shumë objekte, prona, që janë pronë komunale dhe shfrytëzohen pa kurrfarë letrash, pa kurrfarë qiraje dhe nuk i drejtohen askujt kurrë.

Kërkoj që në këtë drejtim edhe drejtoria përkatëse t'i hyjë hulumtimeve dhe t'i sheh të gjitha këto pjesë, këto parcela, qofshin sipërfaqe të vogla apo të mëdha, të

futen nën kontroll, nën taksa të Komunës edhe pjesët tjera që mund të shfrytëzohen të jepen, por në bazë të ligjit, me ofertë të tregut, ai që ofron më shumë, ai që ka mundësi dhe kapacitet me materializuar më mirë edhe me paguar taksën.

Pasiqë janë bërë disa shkelje dhe duke pasur parasysh se edhe arsyetimi nuk është i plotë, këtë propozimrregullore nuk e votoj.

Feti Mehdiu në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se në këtë vendim është dashtë të parashihet, të shënohet se kjo pronë është pronë publike komunale, sepse kufizimi pronë komunale është më i paqartë.

Sa i përket çështjes së dhënies së kësaj prone publike të Komunës në shfrytëzim të tjerëve, po shihen shumë gjëra që nuk kanë shkuar si duhet, dhe për këtë nuk kemi pasqyrë të qartë se nuk është dhënë sqarimi se si është vepruar. Pajtohem me ato vërejtje që i dha z. Veseli, se pa pas një raport, pa pas një analizë kush si e ka shfrytëzuar, e mandej të merren masa tjera ata që e kanë keqpërdorur a mund të marrin pjesë prap në atë konkurs dhe si të vepron.

Partia e Drejtësisë do të përmbahet nga ky votim, nuk do të jetë kundër për shkak se sigurisht kemi besim në komisionet.

Apeloj që këto komisione të kenë kujdes që kur të vendosin për këto gjëra, të kihet parasysh që segmenti i drejtësisë të mos ngelet anash.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, kërkoi të dijë se personat, të cilët janë në këtë listë e që propozohen për vazhdimin e kontratave, të cilat i parasheh kjo rregullore, a janë ata që e shfrytëzojnë këtë hapësirë apo jo, dhe a keni marrë një përgjigje të tillë dhe, nëse jo, atëherë pse na është sjellë kjo rregullore.

Ky diskutim i diskutimit të kësaj rregulloreje për mua flet shumë për moralin politik, respektivisht për mungesën e tij krejtësisht. Përpyekja për të trajtuar të gjitha nivelet e qevrisjes si shkelëse të ligjit, flet shumë pikërisht për vazhdimin e shpërlarjes së trurit që ka filluar në këtë hapësirë qysh në vitet e 90-ta, duke i përlyer të gjithë. Vetëm kështu qytetari qitet para aktit të kryer, atij i thuhet nuk ke çka bënë, nuk ke kah zgjedhë, të gjithë jemi hajna! Përpyekja për të ngritur shenjën e këtij barazimi në mes të të gjitha forcave politike, nënkupton logjikën mafioze tipike për Italinë pas Luftës së Dytë Botërore.

Kësaj rregulloreje i mungon arsyeshmëria reale, që do duhej të ishte në përputhje me interesin publik.

Nenet: 4, 6 dhe 7 të Ligjit për prokurorim publik, i rregullojnë këto çështje dhe ato u potencuan qartë, dhe për këtë dua ta falënderoj kolegun Veseli, me që nuk e kisha atë ligj. Ndërkaq, në këtë arsyetim nuk janë marr parasysh as ky ligj, as rregulloret paraprake. Kuvendi përmes kësaj rregulloreje, bëhet, siç po rezulton, shkelës i ligjit, në vend që të ishte mbrojtës i tij. E keqja është se zhveshja e politikës nga përgjegjësia dhe morali bën që rregulloret e këtilla të na sillen këtu dhe të pajtohem me këtë formë të shkeljes së ligjit. Meqë Vetëvendosja pretendon t'ia kthejë moralin dhe etikën qytetare shtetit dhe qytetarit, pra edhe politikës, propozoj që ky vendim të tërhiqet nga rendi i dites, të korrigjohet edhe më tej, pastaj të sillen të shqyrtohet edhe një herë.

Në këtë formë ashtu si është sjellë, nuk e miratojmë këtë rregullore dhe i bëj thirrje ndërgjegjes së secilit deputet, veç e veç, të rrezonojë para se të votojë.

Naim Makolli shprehu mendimin se ato parcela publike që sot i kemi nëpër Prishtinë e që akoma menaxhohen prej Komunës, fatkeqësisht janë të mbushura

me mbeturina, ndërsa këto që dikush i menaxhon sot, kanë një pasqyrë tjetër. Mandej, shefi i GP të PDK-së e përmendi se po pasurohen, unë shumë e shoh të arsyeshme se gjithkush që e merr një parcelë me qira, ai e merr për t'u pasuruar, edhe me këtë gjuhën që e përdorën sot shefat e grupeve parlamentare, më duket që i bëjmë dëm biznesit të Komunës së Prishtinës.

Të gjitha këto parcela, po e kritikoj edhe shefin e grupit tim parlamentar, edhe pse e pat një gjuhë më të butë, por pak u çudita edhe me shefin e LDK-së, sepse bënë pjesë në grupin e bizneseve, të njerëzve që merret me biznes, edhe duhet ta kuptoj edhe këtë se bizneset që zhvillohen bëhen edhe me bashkëpunëtorë të tjerë.

Por, në përgjithësi kur merret një pronë me qira, neve duhet të na interesojë më tepër se a është i rregullt me qira, a e bën një biznes të mirë aty etj. e jo në këtë formë qysh folëm ne sot, sepse i bëjmë dëm të madh zhvillimit të biznesit.

Me shumicë votash, shtatë kundër, tri abstenime, u miratua vendimi për vazhdimin e afatit të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale.

Pika e katërt dhe e pestë

Për Propozimvendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe të Statutit të Qendrës së Mjekësisë Urgjente, informoi **Agim Salihu**. Ai tha se në bazë të dispozitave të Ligjit për vetëqeverisje lokale është themeluar një komision, i cili ka bërë disa ndryshime dhe plotësime të statuteve të të dy qendrave.

Musli Mehaj, në emër të GP të LDK-së, tha se me një seriozitet të madh i kemi analizuar këto dy propozimvendime dhe njëzëri pajtohemi që këto dy propozimvendime të miratohen nga ky Kuvend, duke pasur një arsyeshmëri shumë të fuqishme për harmonizimin e ligjeve në nivel të Kosovës, në organizimin më të mirë të mjekësisë në komunën e Prishtinës, si dhe funksionimin e shërbimeve.

GP i LDK-së i përkrah këto dy propozimvendime për miratim.

Naim Makolli në emër të GP të AKR-së, tha se i kemi shqyrtuar këto ndryshime në të dy statutet e këtyre qendrave të mjekësisë dhe kemi vetëm një vërejtje të vogël. Te neni 11, nën "a", ku thuhet se Departamenti i shërbimeve diagnostike dhe specialistike rentgen edhe laborator, besoj që për të plotësuar këtë departament duhet që në nenin 7, përveç pikave që janë a,b,c etj., të jetë edhe *specialisti i radiologjisë*, sepse Departamenti i radiologjisë dhe i laboratorit nuk mund të funksionojnë nëse nuk e kanë edhe specialistin e radiologjisë.

Me këtë propozim, GP i AKR-së i përkrah këto dy propozimvendime për miratim..

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, tha se edhe ne i përkrahim këto ndryshime dhe plotësime të statuteve të të dy qendrave. Këto propozime për ndryshime janë dhënë edhe më herët, por ne nuk kemi qenë pragmatik për t'i inkorporuar ato ndryshime dhe kjo është një prej fakteve se Zyra ligjore ka bërë një lëshim, ka gabuar që nuk i ka inkorporuar me kohë.

Mejreme Berisha, në emër të GP të AAK-së, tha se pajtohemi me këto ndryshime dhe plotësime dhe i përkrahim për miratim.

Besa Rafuna, në emër të GP të LDD-së, tha se dakordohemi me këto ndryshime, të cilat kanë qenë të domosdoshme. Janë ndryshime shumë logjike dhe me përmbajtje.

Kimet Zeqa, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, shprehu mendimin se këto ndryshime kanë qenë të domosdoshëm. Qysh në vitin e kaluar kam pas propozuar farmacist, ku nuk ka ekzistuar asnjë herë farmacist në QKMF, tash një student duke punuar, më vjen mirë që ka me qenë edhe magjistër i farmacisë. Çështje tjetër është se në Departamentin e shërbimeve specialitike a hynë mjeku i mjekësisë familjare , Mjekësia Familjare dhe Dispanzeri antituberkuloz, ku veç ekziston Dispanzeri antituberkuloz. Një propozim ka qenë kaheerë, të jetë edhe një psikolog, pasi që në bazë të nenit 86 të Ligjit për shëndetësi, mundet të ndryshon për të mirën e qytetarëve, të kemi edhe një psikolog. Do të ishte i mirëseardhur edhe psikologu, sepse për çdo ditë kemi pacientë që kërkojnë të shkojnë tek psikologu, sidomos në pediatri, ku fëmijët

deri në moshën 15 vjeçare i kanë shërbimet në pediatri. Edhe ky plotësim mund të jetë ndoshta vitin e ardhshëm, pasi që mundet të plotësohen ndryshimet dhe të përmirësohen në të mirën e qytetarëve.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se i ndëgjuam vërejtjet që u dhanë këtu nga profesionistët për këto propozimvendime dhe diçka të veçantë nuk kemi për të shtuar, me përjashtim të rastit që u theksua këtu tek psikologu, të cilën e kemi pas edhe ne. E përshendesim funksionalizimin e interesit për shëndetin.

Vjollca Dibra tha se kur jemi te këto ndryshime të propozimvendimeve, do doja që të sqarojmë punën e mjekëve dhe të stomatologëve nëpër shkolla fillore. Kemi një pjesë dërmuese të shkollave në Prishtinë që nuk kanë as mjek, as stomatolog. Në shkollën përkatëse ku unë jam, parashihet vendi për stomatolog, mirëpo nuk ka stomatolog. Duhet të jetë një marëveshje në mes Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe të merret një vendim i njëjt për të gjitha shkollat, se a do të ketë apo nuk do të ketë në shkollë mjek apo stomatolog.

Valbon Krasniqi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, u shpreh se i dëgjova me vëmendje sugjerimet e këshilltarëve të Kuvendit. Sa i përket profesionistëve apo specialistëve të lëmenjve të caktuar, të cilët mund të angazhohen në kuadër të mjekësisë parësore, janë të përcaktuara me ligj, përkatësisht me Ligjin e shëndetësisë 2004/4, sa i përket Mjekësisë Familjare, dhe me Ligjin për kujdesin themelor emergjent, i cili specifikon mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Qendrës së Mjekësisë Urgjente. Edhe profesionistët shëndetësorë nga neni 86 i Ligjit për shëndetësi, ku aty pastaj specifikohen edhe lëmenjtë e tjer, të cilët mund të punojnë në kuadër të kujdesit parësor. Ne vetëm po i harmonizojmë këto dy statute me ligjet aktuale në fuqi, e cila e fuqizon më tepër implementimin e konceptit të mjekësisë familjare.

Sa i përket punës së stomatologëve nëpër shkolla, duhet hulumtuar mënyrën, gjithmonë duke i respektuar dispozitat ligjore në fuqi se si do të vazhdojë më tutje me funksionalizimin e këtyre ordinancave stomatologjike nëpër shkolla.

Shefki Gashi shprehu shqetësimin e tij lidhur me punën dhe shërbimin në disa ambulanca, duke thënë se disa shërbime nuk janë në nivel të detyrës. Për të qenë sa më në nivel shërbimi në ambulantat mjekësore, kërkoi që ndaj tyre të jetë një kontrollë më e shtuar dhe një disiplinë më e madhe.

Feti Mehdiu në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, kërkoi nga hartuesit e këtij dokumenti që në vend të emërtimit *Mjekësi urgjente* të jetë *Shërbim mjekësor urgjent*.

Njëzëri u miratuan Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qendrës së Mjekësisë Urgjente.

**Pika e gjashtë dhe e shtatë
Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme.**

Naime Osmani, pyetje për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Pse nuk funksionon laboratorit për analiza mjekësore në Qendrën e Mjekësisë Familjare në lagjen “Kodra e Trimave”, pasi që ekziston si apatarura dhe personeli? Ka shumë ankesa nga pacientët, sepse laboratorit në Qendrën te Xhamia e Llapit është i stërngarkuar. Ju lutem të ndërmerrni masa që ta funksionalizoni laboratorin.

- Kërkesë për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale, nga qytetarët e fshatit Besi.

Banorët e të dy lagjeve të fshatit Besi kërkojnë nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale që të bëhet ndriçimi i rrugës në lagjen e parë (rrugës për Rimanishtë deri te familjet e komunitetit ashkali), si dhe në Lagjen e Bllacajve.

Gjithashtu, në emër të banorëve të fshatit Besi, kërkoj që sa më parë ta përfundoni rregullimin e kanalizimit fekal në lagjen e parë të fshatit, si dhe të fillohet puna për ndërtimin e kanalizimit edhe në Lagjen e Bllacajve.

Shefki Gashi fillimisht ceku se ka, qenë ndoshta përvoja e mëhershme që dimrat nuk kanë qenë aq të vrazhdë sa është ky tani, dhe përgatitjet, sipas të gjitha gjasave, nuk janë paraparë për një situatë të këtillë.

Këtu gabimi ndoshta është edhe diku tjetër, që duhet të parashihen edhe gjendjet apo shpallja e gjendjeve të jashtëzakonshme, e cila përcillet edhe me mjete shtesë, në mënyrë që të përballen me fuqitë mbinatyrore, të cilat mund të ndodhin dhe të cilat janë të pa programuara nga njerëzit.

Gjendjen në qytet e kemi parë të gjithë. Është provuar prej kompanive kontraktuese, është provuar prej të gjithave që të bëjë një zgjidhje, në njëfarë forme është arritur që në disa rrugë kryesore të aftësohen dhe, në njëfarë mase, ditët e para disa rrugë tjera kanë mbetur larg aftësimin, sikur që kanë qenë lagjet: “Bregu i Diellit”, “Velania”, “Vreshtat”, Kodra e Trimave” etj. Pjesët tjera periferike nuk mjafton vetëm që të hapet një rrugë regjionale, cila do qoftë ajo, qoftë rruga që shkon prej Koliqit te Dyzi, qoftë ajo prej Prishtinës që shkon për Leskoc, qoftë ajo që shkon prej Grashticës në Slivovë, sepse territori i shpërndarjes së shtëpive dhe banorëve në komunën e Prishtinës është aq i shkapërderdhur, sa kjo i kushton. Prandaj, është dashur me i paraparë mjetet e caktuara, me ndarë loto të caktuara, jo me ia dhënë një kompanie një rrugë, e cila i ka 1-2 automjete, me të cilat mundet me u pastruar bora, por është dashur me u programuar në atë mënyrë që regjionet me qenë sa më të vogla, lotot sa më të vogla, pagesa me qenë sa më e mirë, edhe pse çmimin e caktojnë konkurrentët, ose me pas rezerva të mjeteve për raste të caktuara.

Çështje tjetër që vlen të theksohet është se këto kompani kanë bërë seleksionimin e rrugëve, kështu që janë anashkaluar lagje të tëra dhe nuk janë hapur rrugët, kanë mbetur të mbyllura. Shumë vendbanime, si Butovci, Lagja e Stullqajve dhe Lagja e Cërvedikëve kanë mbetur të bllokuara. Gjithashtu edhe rrugicat në Llukar dhe Makovc nuk janë hapur. Nga kjo shihet se ka qenë një organizim total i befasishtëm, andaj kërkoj që në të ardhmen të parashihen gjërat pak ma ndryshe.

Milazim Vitija që në fillim tha se kompania "Pastrami" që e ka marrë pastrimin e borës në përgjithësi në komunën e Prishtinës, e kam ditur që do të ketë telashe gjatë këtij dimri. Është edhe procesi që e kam thënë unë në Komitetin për Politikë dhe Financa. Jam për atë që ndërmarrjeve komunale të ndihmohen, por me atë teknikë dhe teknologji që e ka kompania "Pastrimi", nuk ka mundur t'i pastrojë të gjitha ato rrugë që me të vërtetë ka qenë edhe bora në një trashësi shumë më të madhe se viteve të kaluara. Mirëpo duhet të përgatitet kompania, këtë e them me qëllimin më të mirë, nuk desha ta kritikoj askënd, mirëpo qysh tani jemi në gjysmën e dimrit dhe qysh tani duhet të mendohet se duhet të organizohet më mirë kjo punë. Që nga bora e parë kemi shumë lagje të Marevcit që janë të bllokuara, mos të flasim prej borës së fundit janë të bllokuara lagjet: Vakovc, Canaj, Gërbesh, Pacaj, disa lagje të BL të Slivovës, lagja e Kullajve që i takon BL të Mramorit, gjithashtu është e bllokuar rruga për në lagjen Qelevit, BL e Keçekollës dhe disa lagje të Dabishecit, andaj dhe kërkoj që urgjentisht duhet të ndërmerren masa që tani këtyre banorëve të iu dilet në ndihmë duke i pastruar rrugët.

Shumica e rezervave që i kanë pas deri më tani i kanë harxhuar ata banorë dhe tash mendoj që Komuna duhet që edhe për këtë vit, por edhe për vitet tjera, të mendojë shumë se cila kompani po e merr dhe kush mund ta kryejë këtë punë më së miri.

Mejreme Berisha tha se përderisa trajtojmë këtë temë, do t'i shtroja edhe dy probleme tjera të thjeshta. Në Komitetin për Komunitete kemi përfaqësuesit e FSK-së, por pasi që edhe z. Shemsi Veseli është zv. ministër i FSK-së, mënyra më e mirë është që ne të kërkojmë ndihmë dhe t'i lusim këto forcat tona, që të dalin me fuqinë e tyre punëtore dhe të bëjnë pastrimin e rrugëve.

Çështje e dytë është, që ndërlidhet me një problem të gjimnazi "Xhevdet Doda", e që ka të bëjë me kalimin e nxënësve rrugës nga ana e majtë, në djathtë dhe anasjelltas.

Kërkoj që të paktën të bëhet ndonjë shenjzim, pasi që për momentin nuk është paraparë projekti për ndërtim të ndonjë mbikalimi.

Çështja e tretë ka të bëjë rreth një problemi të pazgjidhur vite me radhë, gjegjësisht nga viti 2008, për banorët e fshatit Mat, çështje e ngritur disa herë më parë. Për këtë çështje është njoftuar edhe drejtori i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, andaj dhe kërkoj nga drejtori që përgjigja të jepet me shkrim dhe të dihet se çka është problemi i këtyre banorëve.

Astrit Hasani paraqiti vërejtje për punën dhe angazhimin që e bën kompania "Pastrami", duke shtuar se në parkun "Gërmia", një korsi e rrugës nuk ka qenë

fare e pastruar. Po ashtu, kam vërejtje edhe për trotuare, ku shumica e njerëzve nuk kanë mundur as të ecin për shkak se ka qenë i bllokuar prej borës. Andaj, për arsye se qytetarët aty paguajnë edhe nga 1 €, ju kisha lutur që në të ardhmen kompania "Pastrimi", ta pastroj borën siç duhet.

Sadri Ramabaja shprehu shqetësim rreth gjendjes së krijuar nga të reshurat e borës, duke thënë se të gjithë ne po e vërejmë që kemi kaos në pastrimin e qytetit. U njoftua se zona të tëra janë të bllokuara në pjesën rurale etj., gjithashtu edhe në qendër të qytetit, siç është rruga "Rexhep Luci", ishte e bllokuar krejtësisht, d.m.th krejt pak hapa larg objektit të Komunës.

Këtë gjendje e kanë pasqyruar edhe mediat televizive etj. Çështja është e këtij Kuvendi dhe e kësaj udhëheqje të Komunës, që të jap një llogari, si ka mundësi që të ndodhemi në këtë gjendje pas 5 ditë të pushimit të reshjeve. Kolegu Gashi potencoi disa arsye që këtu ka munguar organizimi, nuk dëgjova asnjë fjalë as nga kryesuesi e as nga të tjerët, që janë përgjegjës që të kërkohet llogari nga ato tri kompani që kanë marrë përsipër dhe, natyrisht të japin përgjegjësi të plotë. Në institucionet me përgjegjësi, në rastet e tilla, madje edhe Kryetari i Komunës do të vihej në diskutim të jap dorëheqje, le më drejtori apo ndonjë rast i ngjashëm etj. Gjendja është relativisht alarmante, ndërkaq pas 2-3-4 ditëve, sipas parashikimit të motit, do të kemi borë sërish dhe atëherë do të jemi në kolaps komplet, prandaj dua të potencoj këtë që do të ishte tepër urgjente sot ose nesër që të ndërmerret diçka.

Naim Makolli shtroi pyetjen se për lagjen "Kodra e Trimave", cila kompani është kompetente për pastrimin e rrugëve. Këtë e them se përveç rrugës kryesore "Vëllezërit Fazliu", asnjë rrugë tjetër nuk është pastruar nga bora.

Agim Gashi, drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tha se duke pasur parasysh vërejtjet dhe sugjerimet që u paraqitë nga të pranishmit, len pak përshtypje se nuk është bërë planifikimi i mirë i ndarjes së punëve sa i përket territorit të komunës së Prishtinës për sezonin dimëror.

Drejtorja e Shërbimeve Publike i ka ndarë në 5 lloje shërbimet për mirëmbajtjen e rrugëve në sezonin dimëror. Është tjetër se si ka rezultuar procedura e prokurimit dhe kush sa ka fituar. Ajo është një temë tjetër, që duhet të merret ekzekutivi edhe duhet të merret me atë që të mos përsëriten gabimet e procedurës së prokurimit. Por, tash është momenti, se nuk përfitojmë as ne as ju e as askush tjetër të merremi me këto shtyrje në këtë aspekt, por duhet të merren masat shtesë. Me rastin e rënies së kësaj bore, me përmasa jo normale, janë marrë masa shtesë dhe masat janë ato që janë. Është e vërtet se ende ka rrugë të skajshme, të cilat janë të papastruara dhe tash për tash është vështirë të pastrohen edhe ato, por ato rrugë janë të kalueshme.

Edhe sot, kur po flasim këtu, kompanitë janë duke bërë përpjekje t'i hapin edhe ato pjesë të fundit që tash për tash nuk janë të hapura.

Mbledhja mbaroi në orën 13:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Sami Hamiti, ecc. i dip.